




Republika e Kosovës
Republika e Kosovës – Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës – Vlada Kosova – Government of Kosovo



**QENDRA E STUDENTËVE
E UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS
PRISHTINË**

**STUDENTS' CENTER OF
UNIVERSITY OF PRISHTINA
PRISHTINA**

**STUDENTSKI CENTAR
UNIVERSITETA PRISHTINE
PRISHTINA**



Rruga "Agim Ramadani" p.n., 10 000 Prishtinë, Kosovë

Në bazë të nenit 9 dhe 13, të Statutit të Qendrës së Studentëve të Universitetit të Prishtinës në Prishtinë të datës 05.05.2017, Drejtori i Përgjithshëm i Qendrës së Studentëve të Prishtinës në Prishtinë, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR STREHIMIN E STUDENTËVE NË KONVIKTET E QENDRËS SË STUDENTËVE

Neni 1 Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet dhe kriteret për strehimin dhe ushqimin e Studentëve në Qendrën e Studentëve në Prishtinë.

Neni 2

Në Qendrën e Studentëve në Prishtinë mund të vendosen vetëm Studentët e rregullt të Universitetit publik të Prishtinës, vendbanimi i të cilëve është më larg se 25 kilometra nga Prishtina. Të drejtë konkurimi për vendosje kanë të gjithë studentët e rregullt të UP të Prishtinës.

Neni 3

Shpallja e vendeve të lira për vendosjen në konvikte të Qendrës së Studentëve në Prishtinë, bëhet me konkurs publik i cili shpallet në gazetën e përditshme në Kosovë si dhe në Web: qs.rks-gov.net

Shpallja e konkursit bëhet në fillim të shtatorit të vitit Akademik. Konkursi duhet të përmbajë: Shënimet e domosdoshme të titullarit i cili e shpall konkursin, numrin dhe datën e marrjes së vendimit për shpalljen e konkursit, mënyrën e aplikimit, datën e saktë të publikimit të ranglistës finale të kandidateve të cilët e fitojnë të drejtën e strehimit në konvikte të Qendrës së Studentëve në Prishtinë.

Neni 4

E drejta e vendosjes në konvikte sigurohet përmes aplikimit elektronik (**online**) në mbështetje të dokumentacioneve që parashihet me këtë Rregullore.

Me rastin e aplikimit për fitimin e të drejtës së strehimit studentët duhet të përfillojnë këtë procedurë:

1. Llogaritja e pikëve nga nota mesatare gjatë studimeve, shfrytëzohet nga **Sems-i**.
2. Skanimi elektronik (**online**) i dokumentit përkatës për kategoritë: fëmijë të dëshmorëve, studentë i prindit veteran i luftës, studentë i të pagjeturit, studentë invalid



civil i luftës, studentë i prindit martir nga lufta, studentë me aftësi të kufizuara, studentë i të burgosurit politik, më shumë se një studentë nga një familje konkurrues në QSP (skanohen letërnjoftimet nga secili studentë, të motrës, vëllait, vëlla-vëlla, motër-motër).

♦ *Vlerësimi i dokumentacionit të studentëve konkurrues (llogaritja e pikëve) bëhet nga vet sistemi elektronik në bazë të kriterëve të përcaktuara.*

Neni 5

Kriteret për fitimin e të drejtës për vendosje në konvikte përcaktohen në bazë të pikëve që sjellë dokumentacioni përkatës i kandidatëve konkurrues. Secili nga dokumentet në vijim poentohet me numër të caktuar pikësh, si në vijim:

1. Studentët nga Fakulteti i Mjekësisë, Fakulteti Teknik dhe Fakulteti i Shkencave Matematike-natyrore me notë mesatare 9.0 dhe largësi 25 km, e më shumë nga Prishtina, pranohen në konvikte me automatizëm pavarësisht totalit të pikëve që grumbullojnë.
2. Studentët nga Fakultetet e tjera me notë mesatare 9.5 dhe me largësi 25 km, e më shumë nga Prishtina, po ashtu pranohen me automatizëm pavarësisht numrit të pikëve të grumbulluara.
3. Suksesi i studentëve për notë mesatare vlerësohet nga 5-15, pikë.
4. Largësia e vendbanimit nga Prishtina, vlerësohet nga 2-10 pikë.
5. Studentët jashtë territorit të Republikës, për largësi vlerësohen me .. 15 pikë.
6. Dëshmia-fëmijë i dëshmorit, vlerësohet me 10 pikë.
7. Dëshmia-fëmijë i invalidit të luftës, vlerësohet me 5 pikë.
8. Dëshmia-studentë invalidi civil i luftës, vlerësohet me, 5 pikë.
9. Dëshmia-fëmijë i prindit veteran i luftës, vlerësohet me 3 pikë.
10. Dëshmia studentë i të pagjeturit, vlerësohet me 5 pikë.
11. Dëshmia-studentë i prindit martir nga lufta, vlerësohet me 4 pikë.
12. Studentë me nevoja të veçanta, vlerësohet me 6 pikë.
13. Kategoria me asistencë sociale, vlerësohet me 4 pikë.
14. Dëshmia studentë i të burgosurit politik, vlerësohet me 4 pikë.
15. Më shumë se një studentë nga një familje, aplikant në QSP, vler.me... 3 pikë.

Neni 6

Në konvikte pranohen-vendosen studentët me numër më të madh të pikëve të fituara nga dokumentet e paraqitura.

E gjithë procedura e aplikimit për vende në konvikte nga ana e studentëve zhvillohet në mënyrë elektronike (online).

Neni 7

Komisioni Qëndror, formimi dhe përbërja nga:

Qendra e Studentëve -- 5 anëtar

MASHT-i ----- 1 anëtar

Parlamenti Studentor--- 1 anëtar

Neni 8

Komisioni Qëndror vlerëson dhe verifikon dokumentacionin e aplikantëve studentë të ngarkuar **online** për strehim dhe ushqim. Gjithashtu ky komision formon listën e studentëve të pranuar në bazë të kriterëve të përcaktuara me këtë Rregullore. Komisioni Qëndror publikon listën e studentëve të pranuar në tabela dhe Web faqe zyrtare të QSP-së.

Neni 9

Dokumentacioni për fitimin e të drejtës në strehim duhet të përpunohet në mënyrë elektronike për secilin kandidat konkurrues. Me këtë rast përpilohet ranglista e cila shpallet publikisht në vend të dukshëm në kopje të fortë dhe në mënyrë elektronike në web-faqe të Qendrës së Studentëve të Prishtinës.

Shqyrtimin e dokumentacionit të studentëve konkurrues dhe përzgjedhja bëhet nga Komisioni Qëndror i Qendrës së Studentëve.

Neni 10

Komisioni duhet ta bëjë me kohë publikimin e listës përfundimtare dhe të përcaktoj kornizën kohore për vendosjen e kandidatëve që e kanë fituar të drejtën e vendosjes në konvikte.

Kandidatët e pakënaqur dhe ata të cilët nuk e kanë fituar të drejtën e strehimit, mund të parashetrojnë ankesë me shkrim **online** në afatin e përcaktuar për ankesa në nivel të Qendrës së Studentëve.

Neni 11

Detyrat e komisionit qëndror janë:

- Të bëjë monitorimin, verifikimin e tërë dokumentacionit- procedurës për përzgjedhjen e kandidatëve për vendosje në konvikte.
- Në rast dyshimit të bazuar të bëjë kontrollimin e tërësishëm të dokumentacionit të kandidatëve konkurrues.
- Në rast të ekzistimit të fakteve që dëshmojnë shkelje të rënda, rishqyrton tërë procedurën e shqyrtimit, sistematizimit dhe rangimit të dokumentacionit të kandidatëve konkurrues.

Pas përfundimit të procedurës, Komisioni merr vendim meritior brenda afatit për pranimin e studentëve në konvikte.

Vendimi i Komisionit Qëndror është përfundimtarë.

Neni 12

Vendosja e studentëve në konvikte bëhet sipas sistemit të vendosjes 9 (nëntë) mujore.

Me propozim të Qendrës së Studentëve dhe miratim nga MASHTI, mënyra dhe shuma e pagesës për banim dhe ushqim mund të ndryshohet.

Sipas kushteve të tregut dhe arsyeshmëri ekonomike mund të lëvizë çmimi dhe sistemi i pagesave.

Studentët vendosen në konvikte sipas skemës së caktuar nga Komisioni Qëndror i Qendrës së Studentëve.

Neni 13

Ankesat e studentëve konkurrues i drejtohen Komisionit për ankesa.

Komisioni për ankesa formohet nga QS.

Komisioni për ankesa përbëhet nga:

Qendra e Studentëve --- 4 anëtar.

Parlamenti Studentor, --- 1 anëtar.

Komisioni për lirim formohet nga Drejtori i Përgjithshëm i QS-së. Lirimet nga pagesat bëhen në përputhje me kriteret dhe vendimin të cilin e merr MASHT.

Komisioni për lirim përbëhet nga 3 anëtarë të QS-së.

Neni 14

Ankesat e kandidatëve të pakënaqur i drejtohen komisionit për ankesa në nivel të Qendrës së Studenteve.

Ushtrimi i ankesave bëhet përmes **sistemit online** në afatin e caktuar nga Komisioni për Ankesa i QSP.

Anëtarët e Komisionit për Ankesa nuk mund të jenë anëtarë të Komisionit Qëndror dhe anasjelltas.

Neni 15

Viti kalendarik i strehimit të studentëve në Qendrën e Studentëve fillon më 01 tetor - 30 qershor.

Në periudhën prej 1 – 15 korrik, Qendra e Studentëve mund të punojë me një konvikt, nëse kërkesat nga studentët-banues janë së paku nga 200 student.

Studentët e interesuar për vendosje gjatë kësaj periudhe duhet të paraqiten me kohë tek personi zyrtar i konviktit, brenda afatit të cilin e cakton Qendra e Studentëve.

Nëse numri i të paraqiturve është i vogël (ska arsyeshmëri ekonomike) nuk ka banim me recepcion në këtë periudhë kohore.

Qendra e Studenteve nga një (1) shtatori punon me recepcion për studentë, varësisht nga kërkesat- numri i të interesuarve.

Neni 16

Studentët të cilët sigurojnë të drejtën e vendosjes në konvikte të Qendrës së Studentëve duhet ta bëjnë rregullisht pagesën për strehim. Në rastet kur nuk përmbushet me kohë obligimi i pagesës, studenti banues në konvikt e humbë të drejtën e banimit dhe ai duhet ta lëshoj konviktin.

Pagesa mujore e strehimit bëhet çdo muaj nga data 27 deri me datë 07 të çdo muaji vijues, në xhirollogarinë e Qendrës së Studentëve në cilëndo bankë afariste në qytet.

Studentët-banues të cilët e lirojnë konviktin para nëntëmujorit duhet ta lajmërojnë personin zyrtar të konviktit një muaj më parë.

Neni 17

Studentët para se të vendosen në konvikte informohen për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre si banues i ardhshëm në konvikte të Qendrës së Studentëve, nevojës së deponimit të depozitës, shumën e pagesës, kushtet dhe kriteret për kthimin e tij.

Të drejtat dhe përgjegjësit, depozita, shuma dhe mënyra e kthimit përshkruhen hollësisht edhe në Rregulloren mbi depozitën.

Me rastin e vendosjes studenti pajiset me:

- ID kartel të konviktit.
- Inventarin për banim (plaf, jastëk, çarçaf, këllëf të jastëkëve, etj.),
- Ekstrakti i Rregullores të rendit shtëpiak në hyrje të konviktit,
- Revers përkatës për inventarin që e shfrytëzon.

EEEL
17/01/2024
TINE
RISH
17/01/2024

Neni 18

Banuesit konviktorë duhet tu përmbahen rregullave dhe disiplinës të përcaktuara nga Qendra e Studentëve. Studentët të cilët e kanë fituar të drejtën e banimit para se të vendosen në konvikte u jepet mundësia e leximit të të drejtave dhe përgjegjësisive të cilat janë të specifikuara me Rregullore përkatëse.

Në rastet kur nuk respektohen ato, banuesi në konvikt e humbë të drejtën e banimit.

E drejta e banimit humbet edhe në këto raste:

- Kur banuesi nuk i përmbushë obligimet financiare ndaj Qendrës së Studentëve për shfrytëzimin e kapaciteteve për vendosje.
- Kur e prish rendin dhe qetësinë në konvikt.
- Kur e dëmton rëndë inventarin e dhomës, përkatësisht konviktit.
- Kur e humbë statusin e studentit të rregullt konform dispozitave të Statutit të Universitetit të Prishtinës.
- Kur me sjellje, veprim ose mosveprim u shkakton dëm bashkëbanuesëve të tjerë,
- Nëse dënohet më tepër se gjashtë muaj burgim.

Neni 19

Të gjithë studentët-banues të konvikteve mund të ushqehen në mensën e studentëve nga dy shujta në ditë.

Kartelat për ushqim, studentet banues mund ti marrin në konvikte tek personi zyrtar i pagesave për kohën prej 15 apo 30 ditëve për muajin e caktuar, pasi të kenë bërë pagesën në ndonjërin nga bankat afariste.

Neni 20

Në kompleksin e konvikteve studentët mund të shfrytëzojnë edhe infrastrukturën tjetër që ofron Qendra në harmoni me rendin e caktuar shtëpiak për shfrytëzim si:

- Sallën e leximit.
- Sallat për TV.
- Palestrën e sporteve "1 Tetori".
- Terrenet sportive.
- Internet-Wi-fi.
- Lavandarin për pastrimin e rrobave etj.

Terrenet sportive, Salla "1Tetori" dhe Lavandaria duhet të shfrytëzohen nga studentët konviktor sipas orarit të cilin e cakton Drejtoria e Qendrës së Studentëve.

Neni 21

Ndryshimi

Ndryshimi apo plotësimi i kësaj Rregulloreje mund të bëhet nga organi kompetent, së paku dy muaj para shpalljes së konkursit për vendosjen e studentëve në konviktet e Qendrës së Studentëve.

Ndryshimi dhe plotësim i Rregullores mund të bëhet edhe me vendim të veçantë të QSP-së, ose MASHT-it.

Neni 22

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për strehimin e studentëve në Qendrën e Studentëve në Prishtinë, nr.113 te datës 29.03.2017

Neni 23
Hyrja ne fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm i Qendrës së Studentëve.

Prishtinë

29.12.2022

Drejtori i Përgjithshëm
Fatmir Sfishta

